

VENDIM QARKULLUES

Nr. 21, datë 14.9.2018

PËR PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS VENETO SHA, TË PËRTHITHUR NGA BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014, “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4, të udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014, “Për sigurimin e depozitave në banka”, të ndryshuar, të nenit 10, pika 6, të Rregullores, “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 24, pika 1, shkronja “k”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 20, pika 1, të rregullores, “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar me vendimin nr. 36, datë 26.5.2010, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 220, pika 3, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 60, datë 6.9.2018, “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Bankës Intesa Sanpaolo Albania sh.a., me Bankën Veneto sh.a.”, me propozim të drejtorit të përgjithshëm, Këshilli Drejtues

VENDOSI:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën Veneto sh.a., të përthithur nga bashkimi me Bankën Intesa Sanpaolo Albania sh.a.
 2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Veneto sh.a. Ngarkohet Banka Veneto sh.a., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Banka Intesa Sanpaolo Albania sh.a. që të mbajë të veçuara depozitat e siguruar të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tremujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës Veneto sh.a., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.
 5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës Veneto sh.a., si shoqëri e përthithur.

**KRYETAR
Donald Duraj**